

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Separol® N

DISARMANT

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Separol® N është disarmant mineral me bazë vaji, viskozitet të ulët dhe gati për përdorim i cili ofron shkëputje të plotë të betonit ose grautit nga betoforma e lëmuar. Nuk njollos, zgjat kohën e shërbimit të betoformës dhe ofron finiturë betoni me estetike të lartë.

PËRDORIMET

- Disarmant për betoforma absorbuese ose jo absorbuese
- Ofron finiturë estetike të cilësisë së lartë për betonin e derdhur dhe të parafabrikuar
- Zgjat kohën e shërbimit të betoformës

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Gati për përdorim
- Efikasitet i mirë për shkak të viskozitetit të ulët
- Jo korrodues
- Aplikim i lehtë
- Shkëputje dhe pastrim i shpejtë i betoformës
- Zgjat kohën e shërbimit të betoformës
- Siguron beton me sipërfaqe të pastër, e cila e bën ideal për betonet arkitekturore
- Redukton filluskat e ajrit të cilat mund të shfaqen mbi sipërfaqen e betonit
- Konsumim ekonomik
- I përshtatshëm për aplikime në betoformë të përdorur në trajtimin me nxehtësi të betonit të parafabrikuar dhe në segmente me nxehtësi të lartë (betoformë deri në +70°C)
- Të gjitha llojet e betonit
- Rezistencë ndaj vibrimit

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	Bidon 27 L ose fuçi 200 L.
Paraqitja / Ngjyra	Lëng / i verdhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.
Dendësia	~0,90 kg/l (±0,05 kg/l)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Betoformë druri	~15–22 m ² /L
	Betoformë metalike ose plastike	~31–60 m ² /L

Konsumimi varet nga ashpërsia dhe absorbueshmëria e betoformës. Këto vlera janë teorike dhe nuk përllogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

UDHËZIME APLIKIMI

APLIKIMI

Duhet t' i referoheni gjithmonë dokumentacionit shtesë aty ku aplikohet, si Method Statement përkatës, manuali i aplikimit dhe udhëzimet e punimeve apo instalimit.

Përgatitja e sipërfaqes

Të gjitha sipërfaqet që do të vishen me Sika® Separol® N duhet të jenë të pastra, pa pislleqe, vaj, pluhur, graso dhe pa mbetje betoni ose grauti. Betoforma prej çeliku duhet të jetë e thatë. Betoforma e përdorur duhet të pastrohet përpara përdorimit të Sika® Separol® N.

Aplikimi

Siguroni përzjerje të plotë përpara aplikimit.

Aplikoni një shtresë të hollë të njëtrajtshme dhe të vazhdueshme Sika® Separol® N mbi të gjithë zonën e betoformës së lagësht ose të thatë, me furçë, rul ose pajisje për spërkatje.

Për finiturë betoni me estetikë arkitekturore, konsumimi mund të adaptohet.

Në të gjitha rastet, duhet të kryhet një testim paraprak përpara aplikimit të plotë.

Pastrimi i pajisjeve

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me tretës pastrimi, shkrirës ose petroleum ether menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Sika® Separol® N i freskët pas aplikimit duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 1 orë. Kur të jetë i thatë ka rezistencë ndaj kushteve të motit.
- Është thelbësor pastrimi i sipërfaqes së betoformës pas çdo përdorimi dhe përpara aplikimit të disarmentit, për të parandaluar formimin e koreve të mbetura prej betoni.
- Gjatë aplikimit në zona të mbyllura, kanale, kulla ashensorësh, etj. duhet të ofrohet ajrosje e mjaftueshme
- Nuk lejohet zjarri i ndezur apo agjentë që mund të marrin flakë (p.sh. punime saldimi) gjatë aplikimit
- Gjatë aplikimit duhet të mbani veshur pajisje mbrojtjeje të përshtatshme
- Shmangni rrjedhjen e Sika® Separol® N në tokë, kanale kullimi dhe rrjedha ujore

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositet pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Separol® N

Shtator 2019, Botimi 03.01

021405021000000032

SikaSeparolN-sq-AL-(09-2019)-3-1.pdf